

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, Kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”, pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”; **APLIKIM PËR NDRYSHIM LEJE MJEDISI TIPI B PN-4820-03-2017. Shtim veprimtarie me ID 6.2 Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen**
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; **SUBJEKTI RADA OIL INDUSTRY, L21410501A**
3. Adresën e vendodhjes së instalimit: **Fshati Shkallnur, Zona Kadastrale 3385, Pasuria Nr.585, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, Qarku Durrës.**
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
Aktiviteti kryhet në fushën e “Menaxhimit të mbetjeve”, dhe “Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza” me:
ID 5.3 b Asgjësim i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1. a) ose lëndfillimint (5.2.a).
ID 5.10 a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme.
ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme
Veprimtaria që shtohet ID 6.2 Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen
5. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
6. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; Nuk ka
7. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; **Agjencia Kombëtare e Mjedisit.**
8. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; **info@akm.gov.al**

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi

RADA OIL INDUSTRY

Orjeta LIKAJ

